



NJOFTIM
RISHPALLJE PUBLIKE PËR QIRADHËNIE

Njësia Nr.	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Emërtimi i Asetit	Vendndodhja e asetit/pronës (Adresa)	Sipërfaqja m ²	Qiradhënie mujore/vjetore sezonale)
Njësia 1	NSH "Inex Sharr Planina në Brezovicë"	Restorant Expres	Hotel Molika	336.80 m ²	Qira Mujore
Njësia 2	NSH "Inex Sharr Planina në Brezovicë"	Toka (Parking)	Parcela në ZK Vërbeshticë Parcela 5513 dhe 5514 (Parking) përballë "Mala Brvnarës"	3434 m ²	Qira Mujore

Kushtet e përgjithshme:

- Periudha e Qiradhënies është për 1 vit me mundësi vazhdimi gjithashtu edhe ndërprerje për shkaqe të privatizimit ose çështjeve tjera relevante. Për shfrytëzim komercial aplikohet qiraja mujore kurse për shfrytëzim bujqësor aplikohet qiraja vjetore(sezonale);
- Qiramarrësi potencial duhet ta paguaj me një këst shumën që është e barabartë me shumën pagesës së qirasë për një muaj menjëherë pas nënshkrimit të kontratës;
- Ofertat mund të bëhen në mënyrë individuale për secilën njësi veç e veç;
- Ofertat duhet të dorëzohen personalisht apo në rast që dorëzohen në emër të qiramarrësit pala duhet ta ketë autorizimin e noterizuar tek noteri;
- Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur (një zarf – një ofertë për një njësi): nr i Njesisë, emri i NSh-së, Emërtimi i Asetit dhe vendndodhja e asetit në zyrën qendrore të AKP-së në Prishtinë.
- Në zarf (jashtë) duhet të specifikohet: nr. i Njesisë, emri i NSh-së dhe vendndodhja e asetit.
- Në rastet e qiradhënies në vlera mbi € 1,000 mujore, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garancionin bankar (jo letër zotimi nga banka) apo garancionin e lëshuar nga Kompania e licencuar e Sigurimeve. Garancioni duhet të jetë në lartësin e vlerës së gjashtë (6) qirave mujore sipas kontratës;
- Për dorëzimin e ofertës duhet të përdoret **Formulari për Dorëzimin e Ofertës** i cili mund të merret në Zyrën Qendrore të AKP-së Divizioni për Kontroll dhe Administrim Direkt, apo të shkarkohet nga ueb-faqja: www.pak-ks.org
- Kriteri për përzgjedhjen e ofertuesit fitues të njësive përkatëse do të jetë çmimi i ofertës më të lartë;
- Ofertat do të pranohen me datë **07.12.2023** prej orës 13:20 – 14:20 në zarf të mbyllur.
- Zarfet do të hapen publikisht në Zyrën Qendrore të AKP-së me datë **07.12.2023** në ora **14:25**;
- Ofertat përmes faksit nuk do të pranohen;
- Palët e interesuara për shikimin fizik të aseteve dhe për marrjen e informatave për gjendjen e tyre mund ta kontaktojnë Drejtorin Menaxhues të NSH Inex Sharr Planina Brezovicë z. Petar Simic në nr. tel 045/583-900. Sipërfaqet e prezantuara më lart janë të përafërta dhe të dhënat më të sakta me ortofoto mund të merren te personi kontaktues i lartpërmendur.
- Kjo shpallje në gjuhën Shqipe dhe Serbe përpos që do të publikohet në media në Kosovë do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të AKP-së;
- Në çmimin e ofertës totale duhet të përfshihen të gjitha tatimet e aplikueshme në Kosovë, (përfshirë edhe TVSH 18%, etj);
- Ne ato raste kur ekzistojnë dy oferta të njëjta, çështja rregullohet që ofertuesi i parë për nga koha, ka përparësi;
- Fituesi potencial obligohet të vendos orën e rrymës në këtë aset ndaras nga objekti i Hotel Molika si dhe duhet të bën hapjen dhe mbylljen e një dere ndarëse me pjesën tjetër të objektit të Hotel Molika

Pagesa e Qiramarrjes:

Ofertuesit fitues është i obliguar që të paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore, duke filluar me pagesën e parë të caktuar në fillimin e kësaj Kontrate të Qirasë, dhe, deri në masën që është e zbatueshme, me pagesa mujore në vijim, të caktuara në të njëjtën ditë të muajit vijues, (apo më herët në rast se data e pagesës së parë apo ndonjë pagesë tjetër mujore rastis të jetë ndonjë festë publike).

Dispozita të përgjithshme:

Pronat /asetet e Ndërmarrjeve Inex Sharr Planina Brezovicë, paraqitur si më lartë ofrohen për qiradhënie dhe Ofertuesit kanë përgjegjësinë të verifikojnë përshkrimin dhe kushtet e aseteve (gjendjen faktike) dhe AKP do të konsiderojë se ofertuesit kanë dijeni të mjaftueshme në lidhje me pronat e ofruara për qiradhënie dhe nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë pengim të posedimit/shfrytëzimit eventual.

Të gjitha njësitë ofrohen për qiradhënie si njësi te veçanta.

Në rast se ofertat janë nën çmimin e tregut te vlerësuar bazuar në asetet e tjera te dhëna me qira, komisioni për vlerësimin e ofertave ka te drejte te refuzoj ato oferta.

Ofertuesit me ndalesë ofertimi:

- Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore, ndaj të cilëve Agjencia apo NSh -ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirimin e pronës dhe kompensimin e dëmeve eventuale;
- Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) personat fizik ose juridik të cilët nuk kanë paguar gjokat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesëpadie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

Ofertat do të pranohen me 07.12.2023 prej orës 13:20 – 14:20 në zarf të mbyllur në:

Zyra Qendrore e AKP-së në Prishtinë; Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Nr. 55 Lakrishtë, 10000 Prishtinë

Tel: 038/500-400 lok. 1130; e-mail: info@pak-ks.org; www.pak-ks.org